

## ORGANIZATAT ANËTARE TË FORUMIT KULTUROR:

*(Lista sipas alfabetit)*

**7 ARTE – MITROVICË-** Mbështetje artistëve, veçanërisht filmbërësit, zhvillimi dhe promovimi i kulturës së përbashkët evropiane; promovimi i artistëve dhe industrisë kreative; prodhim i skenarëve, filmave, performancave tjera artistike; shkëmbime kulturore në nivel rajonal e ndërkombëtar.

**ALO – PODUJEVË-** Promovim i teatrit dhe filmit nëpërmjet produksione të saj apo përmes organizimeve të ndryshme të shfaqjeve filmike në Kosovë dhe në veçanti në vendet me infrastrukturë të dobët kulturore; organizimi i aktiviteteve tjera artistike.

**ALTER HABITUS – PRISHTINË-** Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë është institut alternativ akademik feminist që mëton të përhap dijen dhe të krijojë hapësirë për mendimin kritik dhe kreativ, drejt formësimit të mëtutjeshëm të angazhimit kulturor e politik në Kosovë.

**ARS KOSOVA FOUNDATION– PRISHTINË-** Promovimi dhe organizimi i festivalit të muzikës klasike.

**ARTPOLIS– PRISHTINË-** Artpolis është një organizatë joqeveritare kosovare që promovon kulturën, artin dhe bashkë-ekzistencën multi-etnike përmes dialogut shoqëror, dhe përdore teatrin si një shtyllë për të promovuar diversitetin. Themeluar më 2004 misioni primar është të ngrit zhvillimin kulturor përmes një dialogu të hapur shoqëror.

**ATTA (Akademia për Trajnim dhe Asistencë Teknike) – PRIZREN-** ATTA është e profilizuar në ndërtim të kapaciteteve të grupeve formale dhe jo-formale për menaxhim të qëndrueshëm, zyrtarëve të administratës publike, hartim të politikave publike, kulturë dhe integritet evropian.

**DOKUFEST – PRIZREN-** Organizimi i filmave dokumentar dhe të metrazhit të shkurtër, festivali i filmit "Dokufest", trajnime për filma dokumentarë, etj.

**EC MA NDRYSHE – PRIZREN-** Trashëgimia kulturore, politikat kulturore, politikat kulturore lokale dhe integritet evropian.

**Fondacioni për Trashëgimi Kulturorë "LEGATUM" – PRIZREN-** Mbrojtje e trashëgimisë kulturore; trajnime, seminare, punëtori të ndryshme.

**FRYMA E RE – PRISHTINË-** Organizimi i ngjarjeve kulturore: koncerteve, festivaleve, ekspozitave, shfaqjeve teatrale dhe ngjarjeve të tjera kulturore në shërbim të vetëdijesimit në fushën e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, të fëmijëve dhe atyre me aftësi të kufizuara.

**KOSOVA CHOPPIN ASSOCIATION – PRISHTINË-** Organizatë joqeveritare për organizim dhe koordinim të festivaleve të muzikës.

**LABORATORY FOR VISUAL ARTS– PRISHTINË-** Misioni i organizatës është paraqitja e realitetit artistik në Kosovë: diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik.

**NINE ELEVEN FILM FESTIVAL – PRISHTINË-** Organizatë për produksionin e filmave te metrazhit të shkurtër, organizim të festivalit "Nine Eleven".

**ODA – PRISHTINË-** Promovimi dhe zhvillimi i artit bashkëkohorë - në veçanti artit teatror. Promovimi i artit dhe kulturës jashtë Kosovës dhe zhvillimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e artit dhe kulturës. Politikat kulturore, Arti në edukim.

**ORIN – GJILAN-** Organizatë për produksionin e shfaqjeve teatrale, filmave të shkurtër dhe dokumentarëve që trajtojnë temat shoqërore, organizimi i debateve kulturore, krijimi i laboratorëve artistik dhe zhvillimi i projekteve multietnike kulturore.

**PRISHTINA JAZZ FESTIVAL – PRISHTINË-** Organizimi i festivalit të muzikës xhaz, organizimi i koncerteve muzikore, punëtorive dhe debateve.

**Qendra MULTIMEDIA – PRISHTINË-** Qendra Multimedia në Kosovë punon aktivisht në fushën e artit dhe medias. Ndër aktivitete kryesore të organizatës është produksioni dhe koproduksioni i aktiviteteve kulturore për të gjitha grupmoshat; në nivelin lokal dhe atë ndërkombëtar.

**Qendra për studime humanistike “GANI BOBI” – PRISHTINË**- Qendër për hulumtime, me qëllim të analizave dhe rekomandimeve të adresuara projekteve të ndryshme.

**STACION Qendra për Art Bashkëkohor – PRISHTINË**- Misioni i organizatës është krijimi i hapësirës për artistë, arkitektë, ideatorë e kritikë. Tendencë për krijimin e platformës së hapur për temat sociopolitike, ndërtimin e dialogut të mirëfilltë me publikun dhe përfshirjen e segmentit kulturor në arkitekturë.

**Unioni i Artistëve të Filmit të Kosovës - UAFK** është organizatë profesionale që ka për mision të kontribuoj në zhvillimin e artit kinematografik në Kosovë, si dhe të mbrojë dhe avancoj pozitën e krijuesve të artit kinematografik në Kosovë.

**X40 – PRIZREN**- Promovimi dhe organizimi i aktivitetit kulturor – organizimi i "Bunar Fest 40".

**YOUTH VOICE – NOVOBËRDË**- Promovim i aktivitetit kulturor multi-etnik dhe bashkëkohor.